

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Republike - Government of Kosovo
MINISTRI I PËRZEMBEJESË SË DREKTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT TË
REPUBLICAN

Numri Orig. Orig. Num. Orig. No.	13	Ab Post. Street Postcode	719
No. fletëve Brigjistranca No pages	5	Data Datum Date	14 / 04 / 20 08

Prishtinë / a

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT TË
REPUBLICËS SË SHQIPËRISË**

dhe

**NJËSISË SË AKREDITIMIT TË
REPUBLICËS SË KOSOVËS**

Tiranë

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA),
Bulv "Zhan D'Ark", Nr. 3, Tiranë
Shqipëri

Dhe

Organit Kosovar të Akreditimit
Qyteza Pejton, Rrug, Perandori Justinian, nr 3+5
Prishtinë, Kosovë

Mbështetur dhe në vijim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës dhe qëllimit për të shtuar urat e bashkëpunimit të dy organizmat nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

OBJEKTI I MARRËVESHJES

Të sigurojë një bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet dy organizmave për realizimin e proceseve ekuivalente të akreditimit në vendet respektive.

OBJEKTIVAT E MARRËVESHJES

Organizmat tona, duke u mbështetur në parimet e EA, vendosin:

- i. Harmonizimin e procedurave të akreditimit duke marrë në konsideratë udhëzuesit përkatës të EA, IAF dhe ILAC, me synim njohjen reciproke të akreditimeve të kryera nga të dyja organizmat.
- ii. Adoptimin e praktikave më të mira të anëtarëve të EA-së në akreditimin e laboratoreve, trupave certifikues dhe inspektues.
- iii. Promovimin e pranimit reciprok të çertifikatave dhe raporteve të lëshuara nga organet e akredituara për vlerësimin e konformitetit.



- iv. Të zhvillojnë dhe ruajne besimin reciprok,
- v. Të organizojë dhe shkëmbejë informacion për akreditimin e ushtruar ne të dy vendet tona në nivel kombëtar,
- vi. Të identifikojë dhe nxisë heqjen e barrierave teknike dhe administrative të tregtisë mbështetur ne akreditim,
- vii. Të identifikojë probleme teknike të veçanta të cilat mund te përbëjnë bazën e projekteve të bashkëpunimit,
- viii. Të nxisin marrdhënje bashkëpunimi mes organizmave të infrastrukturës së cilësisë të vendeve përkatëse.
- ix. Të analizojnë tendencat dhe kriteret në fushat e akreditimit si dhe të shkëmbejnë në mënyrë të vazhdueshme njohuritë dhe praktikat e reja,

TË DREJTAT

Me qëllim për të arritur objektivat e kësaj marrëveshje, te dy palët nënshkruese do kenë këto të drejta si më poshtë:

- i. të kërkojnë informacion për veprimtari të palës tjetër
- ii. të marrin pjesë ne takime te grupeve të punës të organizuara nga secila palë
- iii. të marrin pjesë në krahasime ndërlaboratorike dhe kur është e mundur të jenë vetë organizues të tyre,
- iv. të mundësojnë vizita reciproke studimore për kryevlerësuesit, vlerësuesit dhe ekspertët teknikë, për vlerësim me shoqërim, vëzhgim



në fusha me interes të përbashkët.

- v. Të marin pjesë në grupe vlerësimi të përbashkta dhe të organizojnë akreditime të përbashkëta.
- vi. Të marin pjesë në aktivitete trajnimi të zhvilluara nga pala tjetër.
Tarifa e trajnimit do jetë falas për stafin e institucioneve.
- vii. Të shkëmbejnë kryevlerësuesit dhe vlerësuesit. Tarifat e akreditimit do jene të njëjta me ato të aplikuar në vendin e origjinës.


DETYRIME

Secila nga palët nënshkruese angazhohet në ndjekjen e objektivave dhe detyrimeve të kësaj marrëveshje. Në veçanti detyrimet e secilës palë janë:

- i. Të bëjë të disponueshëm kundrejt kërkesave të arsyetuara dokumentat e punës të konsideruar si jo konfindenciale,
- ii. Të nxisë pranimin e formateve të njohura të çertifikatave të akreditimit,
- iii. Të ruajë konfidencialitetin e raporteve dhe rezultateve nga procesi I akreditimit të dhëna nga pala tjetër,

VLEFSHMËRIA E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Kjo marrëveshje do të hyjë në veprim në mënyrë të menjihershme. Ajo mund të amendohet në çdo kohë me pëlqimin e palëve, dhe në mënyrë periodike do të vlerësohen arritjet. Nëse njëra palë nënshkruese e marrëveshjes, për arsye çfardo, do të tërhiqet nga kjo marrëveshje, ajo duhet të lajmërojë palën tjetër jo



më pak se tre muaj përpara.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është e një natyre tërësisht rekomanduese. Ajo nuk krijon detyrime ligjore për palët nënshkruese.

Përfaqësuesit zyrtarë të palëve firmosin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi në Tiranë me datë 27 Mars 2008.

Për DPA
Agim Anxhaku, Dr. inxh
Drejtor i Përgjithshëm



Për Njësinë e Akreditimit
Ibush Luzha, dp.inxh
Shef i Njesisë

